



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 4600/11 prot., datë 25. 8. 2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 14726/11 prot., datë 30. 8. 2021

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 300, datë 25. 8. 2021

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT SHKOLLOR 2021 – 2022 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 7 të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

U R D H Ë R O J M Ë:

Struktura e vitit shkollor 2021 - 2022 të jetë si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:
 - a) Mësimet fillojnë më 27 shtator 2021 dhe mbarojnë më 17 qershor 2022.
 - b) Pushimet fillojnë 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022.
 - c) Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 18 - 30 qershor 2022.
2. Në arsimin e mesëm të lartë:
 - a) Mësimet fillojnë më 27 shtator 2021 dhe mbarojnë më 24 qershor 2022.
 - b) Për maturat, mësimet fillojnë më 27 shtator 2021 dhe mbarojnë më 8 qershor 2022.
 - c) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022.
 - ç) Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 9 - 30 qershor 2022.
3. Në arsimin profesional:
 - a) Mësimet fillojnë më 27 shtator 2021.
 - b) Nxënësit e klasave të 10-ta për të gjitha strukturat, nxënësit e klasave të 12-ta për strukturën, 2+2 si dhe nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 4-vjeçare përfundojnë mësimet më 24 qershor 2022.
 - c) Nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 2+1+1 dhe nxënësit e klasave të 11-ta për strukturën 2+2 përfundojnë mësimet më 8 qershor 2022.
 - ç) Për të gjithë nxënësit maturantë, viti shkollor përfundon më 27 maj 2022.
 - d) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022.
 - dh) Provimet përfundimtare për kualifikimet profesionale të Nivelit II dhe III të KShK-së zhvillohen në periudhën 8 - 24 qershor 2022.

- e) Provimet përfundimtare të praktikës profesionale të kualifikimeve profesionale të Nivelit IV të KShK-së zhvillohen në periudhën 3 - 8 qershor 2022.
 - f) Provimet e Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale zhvillohen në periudhën 9 - 30 qershor 2022.
4. Urdhri i përbashkët nr. 88, datë 10.05.2021 “Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2021-2022 në sistemin arsimor parauniversitar”, shfuqizohet.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË**

EVIS KUSHI



**MINISTRI I FINANCEVE
DHE EKONOMISË**

ANILA DENAJ

